

Në datat 3 dhe 4 prill 2024 në Budva të Malit të Zi, u organizua Takimi i dytë Rajonal për zhvillimin e një programi rajonal trajnimi për vlerësuesit e jashtëm në kuadër të projektit Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe trajnimit në EJK – EQET SEE dhe komponenti i tij i Sigurimit të Cilësisë (QA).



Gjatë dy ditëve të këtij takimi, Grupi Rajonal i Punës, i përbërë nga ekspertë kombëtarë në zhvillimin e trajnimeve, bashkëpunoi me Pikat Kombëtare të Koordinimit të EQET EJK për Sigurimin e Cilësisë dhe finalizoi një program trajnimi për vlerësuesit e jashtëm, si dhe diskutoi dhe finalizoi materialet e propozuara të programit të trajnimit. Të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan në shkëmbime aktive dhe dhanë rekomandime për avancimin e moduleve të propozuara dhe strukturës për të arritur formatin përfundimtar të programit rajonal të trajnimit për vlerësuesit e jashtëm.

Në periudhën 14 deri 17 maj 2024, do të zbatohet Trajnimi Rajonal për Vlerësuesit e Jashtëm, bazuar në Programin e Trajnimit të rënë dakord, me synimin për të rritur aftësitë, metodat dhe teknikat e pjesëmarrësve për t'i ndihmuar ata në proceset e tyre të vlerësimit. Duke mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të tyre në praktikat e vlerësimit, Trajnimi Rajonal synon të kontribuojë në cilësinë e përgjithshme të arsimit në të gjithë rajonin.

Projekti EQET SEE, veçanërisht komponenti i tij i Sigurimit të Cilësisë, fokusohet në mënyrë strategjike në analizimin e nevojave për trajnim të vlerësuesve të jashtëm, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit dhe përmirësimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Këto aktivitete synojnë të forcojnë aftësitë e agjencive të sigurimit të cilësisë dhe vlerësuesve të jashtëm në Evropën Juglindore dhe Republikën e Moldavisë.